



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëtor / Prodator Kryetari / D. Organizator	31. 05 2021	viti god year
Organizimi / Qendrimi Org. / D. / D. / D.	SKIMSHUK 2756/2021	Sasia Kolicina Quantity 113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 345/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëse, bazuar në Aktgjykimin A.nr.283/20 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.782/2019 të datës 31.12.2019 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi Rruga "Kreshnikët" p.n. Fshati Bardhosh, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

SHPALLET jo kompetent Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur për ankesën me numër A.nr.782/2019 të datës 31.12.2019, të parashtruar nga ankuesi nga Komuna e Prishtinës

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën "Tonist, elektrikist dhe garderober", në Qendrën Kulturore të Fëmijëve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, me datë 31.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 5966/2019 me pretendim ankimor kundër ndërrimit të statusit të nëpunësit civilë të karrierës në pozitën e statusit të zyrtarit publik.

Me datë 09.01.2020 ankuesi njoftohet nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil se nuk ka kuorum për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 31.12.2019 dhe udhëzohet që ti ndjek procedurat e mëtejme dhe në pajtim me ligjin mund të filloj procedurën gjyqësore për hapje të konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 26.04.2021 merr Aktgjykimin A.nr.283/20, të cilin Aktgjykim Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës e ka pranuar me datë 30.04.2021 me numër të protokollit 2122/2021, me të cilin aktgjykim detyrohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 31.12.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 26.04.2021; Njoftimi i datës 09.01.2020; Ankesa e ankuesit e datës 31.12.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e punës e datës 03.12.2019 si dhe Akt emërimi i datës 01.03.2013.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj ankese, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi, ka konstatuar se ankuesi edhe me Akt emërimin e datës 01.03.2013 dhe me kontratën e punës të datës 03.12.2019 është i sistemuar në vendin e punës "Tonist, elektrikist dhe garderober", në Qendrën Kulturore të Fëmijëve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, dhe Këshilli nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj ankese, pasi që ankuesi nuk ka status të nëpunësit civil në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë"*, sepse marrëdhënia e tyre e punës nuk i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil, por lidhet në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka marrë parasysh edhe Qarkoren Administrative Nr. 01/2014, datë 08.12.2014 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike, e cila ka definuar listën e të punësuarve në Institucionet e Republikës së Kosovës të cilët janë përjashtuar nga shërbimi civil, në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku nën numrin rendor 1.3 njëra prej pozitave të funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes që është përcaktuar si pozitë që nuk është nëpunës civil, është pozita „ Zyrtar teknik ose Punëtor teknik (Telefonist, elektrikist, ujë instalues, makinist, shtëpiak, fotokopjues, murator, xhamaprerës, drugdhendës teknik pyelli etj).

Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi që ka shpallë jo-kompetencën e Këshillit për të vendosur lidhur me ankesën, konstaton se ankuesi të drejtën e tij mund ta realizoj në pajtim me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës për kategoritë nëpunësve të administratës të cilët janë të përjashtuar nga shërbimi civil, në pajtim me afatet e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-212 për Punë.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr. 345/2021

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetarë e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

